

ZAHO BALILI  
**PUTH BALLIN TËND SHQIPËRI**  
POEZI

---

BOTIMET TOENA



Zaho Balili

PUTH BALLIN TËND  
SHQIPËRI

*poezi*

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2011

Botuese: Irena Toçi

Korrektore letrare: Nertila Ali  
Përkujdesja grafike: Albana Kuraj  
Kopertina: Lavdie Cenmurati

ISBN 978 - 99943 - 1 - 751 - 6

© Klodian Zaho Balili

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: ++355 4 22 40 116; ++355 4 22 58 893

Fax: ++355 4 22 40 117

E-mail: [toena@toena.com.al](mailto:toena@toena.com.al)

[redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*“Rrjedhin ligjërime zemre  
Vijnë e bëhen vargje  
Kënge”*  
Z. B



## *Në vend të parathënies*

Dua që vargje të hedh gjithmonë në letër  
Dua që era barut vargjet e mia të bien  
Dua që këngët e mia  
Atdheu ti ketë ushtarë, me bajonetë mbërthyer

Dua që në vargje, të derdh gjithë dashuritë  
Dua të gjithë heronjtë të mblidhen  
Do t'ua vë kurorë mbi kokë  
Do t'ia dhuroj Shqipërisë për ditëlindje

Ndonjë do të thotë që paska penë të dobët  
Që vargjet e tij mirë nuk kanë rimuar  
Por zemrën time s'do ta ketë pyetur  
Dhe me zjarrin e saj nuk ka kënduar

Populli im gjithnjë nxori poet  
Dhe poet pa laps e pa fletore  
Që vargjet, thanë me syrin në shënjestër  
Që vargjet, thanë ngulur në llogore

Dhe vargjet e tyre mbeten lapidar  
Dhe vargjet mbetën gojë më gojë  
Në vite, dekada e shekuj çanë  
Dhe erdhën gjer në kohën tonë

Unë nuk jam poet  
Dhe shkollën për poet, nuk kamë mbaruar  
Por vargjet për Shqipërinë, më rrjedhin vetë  
Se jeta e saj me heroizëm është gatuar

Moj Shqipëri, e bukura mëmë  
Moj e shtrenjta gjer në thua  
Lum ky popull që të ka  
Ecën në gjurmët e tua

Botë e tërë mbushur me halle  
Botë e tërë ndezur flakë  
Ti je ngritur mal mbi male  
Çan detin me shtrëngatë

Në vitet e rënda, në vitet e egra  
Ngarkuar me tradhti, mbushur me gënjeshtër  
Ti hapin hodhe të fortë e të rëndë  
Ndërsa hasmi dridhej, ne të thurëm këngë

Dhe kish kënga brënda, gjakun e të rënëve  
Dhe kish kënga brënda, dhimbjen e çdo nëne  
Dhe kish kënga brënda, zjarrin e çdo zemre  
Dhe kish kënga brënda, dritën që do bëje

Sa të jetë, për ty do të këndojmë  
Se dritën e surit ty ta kemi dhënë  
Dhe zjarrin e shpirtit do ta bëjmë këngë  
Shqipëri moj e shtrenjta nënë



## *Kurvelesh pse të dhëmb gjiri*

Kurvelesh o majë mali  
Tek shkrep më mirë stralli  
Tek derdh meloditë longari  
Dhe ngrihen trimat nga varri  
Dëgjohet një këngë malli

Ligjëron, labia te stani  
Nga ligjet këputet xhani  
Nga lotët nuk shuhet malli  
Pa shpuzë, nuk të ngroh zjarri  
Pa djem nuk duron vatani

Kurvelesh, flamur shpalosur  
Përkëdhelur i pa joshur  
Prerë djemtë e të pasosur  
Larë gjak i pa përdhosur  
Hasmi shqyer, handakosur

Kurvelesh pse të dhëmb gjiri  
Pse s'këndon këngë bilbili  
Bijtë që të kërkon syri  
Mbetur botës vetëm filli  
Me merakun tënd të vini

## *Liqjeron, labia te stani*

Nga ligjet këputet xhani  
Nga lotët nuk shuhet malli  
Pa shpuzë, nuk të ngroh zjarri  
Pa djem nuk duron vatani

Kurvelesh, flamur shpalosur  
Përkëdhelur i pa joshur  
Prerë djemtë e të pasosur  
Larë gjak i pa përdhosur  
Hasmi shqyer, handakosur

Kurvelesh pse të dhëmb gjiri  
Pse s'këndon këngë bilbili  
Bijtë që të kërkon syri  
Mbetur botës vetëm filli  
Me merakun tënd të vini

## *Kosova ka djalërinë*

U purzhyte moj Drenicë  
U përflake, u shajove  
Barin që sa po ka mbirë  
Me gjak trimash e mbulove

U skuq ajo tokë e zjarrtë  
U bë si palë flamuri  
Shqiponja nga malet lartë  
Shotën dhe Azemin pruri

Bota kurrë se, kishte parë  
Të vritej një fis i tërë  
Për një natë, me rrënjë tharë  
Për një natë, një mijë gjëmë

Hape syrin moj Evropë  
Hapi sytë, vështro mirë  
Kosova kish e ka zot  
Kosova ka djalërinë

Se për troje ngrihen ç'qenë  
Viganët e historisë  
Isa me Avni Rustem  
Dhe Baca i Dragobisë

## *Ura buzën përmbi culë*

U ul buza përmbi culë  
Ëmbël derdhi melodinë  
Çelën lulet erë shumë  
Dhe ato që s'kishin mbirë

Doli hëna mbrapa malit  
E plotë pesëmbëdhjetë  
U ul mbi culë të djalit  
Zuri të lodronte vetë

Shtyu tutje errësirën  
Dhe dritën i hodhi fshatit  
Shtoi kroi gurgullimën  
Sikur do ti flitë çobanit

Hapi veshëza dritaren  
Zërin e culës dëgjonte  
Doli lehtë-lehtë në bahçe  
Dukej sikur fluturonte

Mori përpjetë monopatin  
I skuqnin faqet si shegë  
Këmbë e saj, s'shkelte as barin  
Si zogu fletë me fletë

Preu cula ligjërimin  
Pyeti fshati: ç'pati vallë?  
Një buzë si trëndafili  
Mbi buzë të djalit ranë

## *Fëminia*

Mu kujtua fëminia  
Kur ëndërroja për jetë  
Ëndërr zgjohesha e flija  
Po jeta s'qënka e lehtë

Rrokullime ditë për ditë  
Vitet e rinisë bukur  
Ndeza zemra me vështrime  
Eca, supet duke tundur

Dhe brodha lule më lule  
Kërkova një manushaqe  
Syri, dukej se thoshe tutje  
Gjiri i saj më thoshte hajde

Pa lindën fëmijët radhë  
Frutë pa fund i dashurisë  
U nda dashuri e parë  
Pak nga pak e tek të gjithë

Ikën vitet, rrodhën lumë  
Po një ditë vitet shterojnë  
Për mbi varrë vetëm dy gurë  
Shok e miq, që të kujtojnë

Thyhet jeta, qelq e bukur  
Dhe s'vjen prapë në këtë botë  
Këtë qelq kush e ngjiti?  
Kush e ngjiti le ta thotë...

## *Gruas*

Harrojmë që ke shpirt  
Të krahasojmë me lule  
Me hënën meit  
Që në prehër ulet

Harrojmë që je shpuzë  
Që s'shuhej natë e ditë  
Dhe në gjirin tënd  
Zjarr marrim të gjithë

Po se marrim hua  
Për një copë herë  
Se kush ka një grua  
Ka hapur një derë

Ka hapur një çerdhe  
Që është aq e ngrohtë  
Sa rrebeshe vitesh  
Nuk e ftohin dot.

Harrojmë, harrojmë  
Kjo është e vërteta  
Por brenda kurmit  
Rrënjët i ka jeta!



## *E vogëla*

Moj e vogëla si loti  
E bukur si lule je  
Moj e vogël një pëllëmbë

Moj balluke e zeza pendë  
Dil moj një natë me hënë  
Për fjalën që kemi dhënë

Syri yt shaminë më dogji  
E bukur si lule je  
Moj e vogëla si bari

Si ta mbushi mëndjen djali  
Me një tufë lule mali  
Me avaze nga longari

## *Ç'më ngacmoue*

Të tre djemtë si lastarë  
Të pa vënë brisk në faqe  
Ti mi solle lahutar  
Mbasi prenë kokën një pashe

Nëpër tinguj, nëpër vite  
Zenel Vatës i the - Hajde  
Sikur dhe ti vetë ta dije  
Që një lab do bënte vargje

Ç'paska Zenel Vata vallë  
Që s'ia mbyll qerpiku synë  
Derë e kullës s'do ta mbajë  
Ç'plagë vallë, i dogji gjinë

Ç'amanet të mban mbi tokë  
Trup gjakosur por të ngrohtë  
Nuset pa pikuar lot  
Burrat, malet ulur kokë

Ç'ka që zemra si pushoka  
Ç'ka që fjala si mbaroka  
Ç'ka martina që s'filloka  
Mashkulli si po duroka

“Pa vramë Pashë Sakati  
Shpirti im nuk ka me dalë  
Kullat frëngjitë të hapin  
Flakën trimat na me marr”

Logu i burrave pse heshti  
Pse u drodh e s’foli fjalë  
Mos erdhi zëri nga bjeshkët  
Apo malet fjalën dhanë

Kush u ngrit ashtu në këmbë  
Sy mbërthyer tek alltia  
Ç’kroje ujë u kishin dhënë  
Ku qe pjekur burrëria

“Të na presë Pashë Sakati  
Në sarajet prej floriri  
Dritë e diellit pa dalë  
Dhe do hajë Pashë Sefiri

Hem, buria-gjëmon logu  
Nuse djemve na u dhamë  
Trupi i Zenelit mbi tokë  
Dasmat le të ndizen flakë”

Një natë fjetën me nuse  
Një natë me ëndrra shumë  
Herë çelnin lulëkuqet  
Herë bora binte mbi kullë

Nata pret mëngjesin  
Dita, natën shkul  
Yjet njëri-tjetrin  
Ndjekin nëpër gjumë

Atë mëngjes vjeshte  
Rendin djemtë tanë  
Fusha pjekur fiqtë  
Bjeshka pjekur thanë

Ç'qenka kaq i shenjtë  
Amaneti i trimit  
Ç'paska kaq forcë  
Zemra për betimin

Paskan mbledhur zemrat  
Gjithë dashurinë  
Nënat lotët tharë  
Presin djemtë të vijnë

Hapuni saraje  
Mos u dridh, o Pashë  
Tre filxhan përmbys  
Gjak e kafe bashkë

Ç'më ngacmove lahutar  
Në shesh te lëmi i kalasë  
Nxjerr paketën, ndez cigare  
Zenel Vata zë të flasë

## *Shqipëri të ndriti nuri*

Këndo, moj shqipe, këndo  
të ndrit nuri  
Për të rënë ligjëro  
tek flamuri  
Majë më majë fluturo  
s'tu drodh syri  
Se gjaku djemve kuq-o  
derdhur lumi  
Shpata jote në çdo kohë  
në dorë burri  
Për liri betuar-o  
këto troje  
Që kur lindin foshnjat-o  
në llogore  
Mjaltë e qumësht zemër-o  
buron gjiri  
Breza trimash rrit me to  
si floriri

## *Në ëndërr më vije*

Në ëndërr më vije  
Në prehër më rrije  
Si sheleg flije  
Këngë dashurie

Si flladi beharit  
Si lulet e majit  
Si sorkadhe mali  
Zbritur bora zallit

Si hënë e pa bërë  
Si mollë pa ngrënë  
Si vesë sa rënë  
Si shpuzë pa zënë

Në jetë të kisha  
Në jetë më kishe  
Unë si qiparis  
Ti si dallëndyshe

Në ëndërr më vije  
Në ëndërr më vjen  
S'ishe fat për mua  
Ishe për të tjerë

S'ishe fat për mua  
Ndaj nuk dua jetë  
Buza ime nxirë  
Kënga ime fletë

## *Kush pi ujë në krua*

Kush piu ujë në gurë  
Që kur lindi u bë burrë  
Kishin gjunjë, por kurrë s'u ulën  
Se kish vendi halle shumë  
Se kish halle Shqipëria  
Gjakun kërkonte liria  
O moj Nëna jon e mirë  
Me barut na i dhe gjinë



## *Dil Hanko*

Doli Hanko, zonja vet  
Tek shtëpia me dy kate  
Vallë gjiri i Hankos ç'mbante

Tre fishek e një nagane  
Foli fort tha: Portën hape  
Ç'u bë pjell e beribate

Mu si maçi me mustaqe  
Se i kamë nja dy inate  
Erdha të lajmë hesape

Po me nusen time ç'pate  
Se ishe rritur binjake  
Krisi një kobure rëndë

Qëllonte Hankua në këmbë  
Nuses shpirtin i kamë dhënë  
I dhashë djalin si ergjëndë  
Se shkel dot, o qen me këmbë

## *Ç'u lënë ata djem*

Pse s'më thua këngë me gojë  
Ç'të ka gjetur Shqipëri  
Ç'i bëre këngët e jetës  
Vetëm këngë vdekje di?

Ku mi ke burrat e parë  
Ku ma ke Ali Pashan  
Që osman vriste me pallë  
Të dy varret dot se mbanë

Ku e ke palcën e djemve  
Ku është gjaku i gjakut tënd  
Mbetur detesh e stëreve  
Dhe lotin fshirë me mëngë

Këputa një fije bari  
Mu dhimbs, në dorë më mbeti  
Ti Shqipe si zanë mali  
Pse nise ç'të rriti djepi

Kemi diell, kemi hënë  
Kemi babë, kemi nënë  
Kemi majën, kemi rrënjë  
Këtu të jemi të tërë

## *Udhët e Evropës*

Mu tret syri duke pritur  
Edhe gjiri larë lot  
Kjo kohë kë s'ka goditur  
Kë s'goditi, le ta thotë

S'u mbyllka qerpiku i kombit  
Shqipëria nuk ka gjumë  
Nënat, tjerrin dhembshurinë  
Etërit, djegin duhan shumë

Mërmërisin nëpër buzë  
Emra vendesh të pa njohur  
Herë s'ua thonë emrat kurrë  
Herë ua thonë të merakosur

Kush i njeh udhët e botës  
Bijtë që ikin në këmbë  
Jo zyrtarët e Evropës  
Ç'më del ashpër kjo këngë

## *Ç'ka mikja që s'flet*

Një natë si gjithë netët  
Shkoi mikja nuk më foli  
Këput lulet lehtë-lehtë  
Sa si plasi kraharori

Po ç'i bëra unë i mjeri  
Po ç'i thashë unë i ziu  
Një fjali që zemra nxori  
S'ja thashë unë, e tha vetiu

Mike të më dalësh prapë  
Në s'më gjetsh në bahçen tënde  
Do më gjesh në gjirin tënd  
Edhe në më gjetsh në gjumë

Zgjomë me buzë të tua  
Buzën time do ta bëj gurrë  
Të të them ato që dua

*Labiëri moj lezet madhe*

Sa nis dita të marrë udhë  
Dalin djemtë e tu furtunë  
Leshverdhat si kushullë

Si trëndafili në buzë  
Të bardhat, si borë e malit  
Hedhur supit xhamadanin

## *Apo pret beharin tjetër*

Ajo buzë pak përmbysur  
I bën hije gropës, mjekrës  
Për të puthur a ka nisur  
Apo pret beharin tjetër

## *Po mikja në mos tregoftë*

S'kam ilaç e s'gjej jatri  
Seç më djeg brenda në gji  
Do pyes miken mos e dijë  
Në mos vet të pyes njeri

Dhe mikja në mos tregoftë  
U djegtë, u përvëlloftë  
Lëmosh udhëve kërkoftë  
Zënë e qyqes mos dëgjoftë

Mos i dëgjoftë qyqes zërin  
Dhe zoti i thaftë prehrin  
Ju bëftë varri për së gjëri  
Plastë se meit më bëri

Ah! Kjo botë e shkretë, botë  
Ca i tretë, ca i mban fortë  
Ca i shkreh, ca i bën zot  
S'di botën tjetër ç'do thotë

Në thëntë si bota ime  
U bëftë copë, e thërrime  
Në thëntë siç thotë zoti  
Pse s'më merr të thahet loti

## *Ah! Moj Tepelenë*

Moj e shtrenjta Tepelenë  
Vetull përmbi, Vjosë ngritur  
Nuse e bukur mbi beden  
Buzë qeshur, ballë ndritur

Vlora zjarr e çikë stërralli  
Të dërgon zën' e Selamit  
Kur Gjermani nga istikami  
Me gjak skuqur xhamadani

Këto gërxhe, këto shkrepë  
Cilin nga trimat nuk panë  
Të falsin, për karadakun  
Të flasin, për Mustafan

Maja e maleve lartë  
Me Asim Zenelin ngjajnë  
Me Abaz Shehun furtunë  
Me Nimete Progonan

Ishin lule, mbeten ujë  
Treqind zemra Labërie  
Gjaku i tyre për liri  
Emrin dhënë në histori



## *Legjenda e një engjëlli*

Një nuse në ëndrra  
Mëkonte një jetë  
Zoti lartë në qiell  
Thoshte s'është e vërtet

Zoti ishte zot  
Ai është një  
Nëna ishte nënë  
Dy s'bëheshin më

Dhe nëna një ditë  
Na lindi një djalë  
Zoti i inatosur  
Deshi që t'ia marrë

Nëna merakosur  
Thotë do lind një tjetër  
Zemrën la te djali  
Gjiri djepit mbetur

Ta lë dhe një herë  
Tha zoti me vete  
Dhe ta tretë ngadalë  
Kocka le ti mbetet

Nëna lindi vajzë  
Të bukur si hëna  
Djalit atë natë  
Zë i therte zemra

Nëna s'flinte gjumë  
Zoti, po e po  
Ti ç'kërkon nga unë  
Ti nga unë, ç'do

Lërma engjëllin ta marrë  
Lëre brenda gjirin tim  
Jo, thotë nëna kreshpëruar  
Se ky është qumështi im

Edhe zoti morri udhë  
Në qiell ku ka selinë  
Do ta marrë se s'është punë  
Atë engjëll aq të mirë

Nëna, nënë si gjithë nënat  
Në gji e ka dhëmbshurinë  
Po dhe zotin e mallkon  
Ditën që i merr fëmijën

Ndaj dhe zoti u tërhoq  
S'kish ç'të bënte ishte nënë  
S'prishte dot folenë me zogjtë  
Engjëllin këtu ka lënë

## *Fryn thellim*

Fryn thellim e bie borë  
Dëgjomë, nënë dëgjomë  
Më mbeti pushka në dorë

Hasmi më dërgon taborë  
Dhanë e morën, dot s'më lodhë  
Barut për fishek dërgomë

Në rënsha, nuses t'i thonë  
Synë e zi të mos e njomë  
Djalin me barut ta kojë

## *Një ves mbi mal ra*

Një ves mbi mal ra  
Shkoi më e bukura  
Ia pa shoqet a si pa  
Dhe i pa dhe çoç u tha  
Ca isharete më dha  
Tek syri i shtrungës më la  
Dy, tri mollë të ëmbla  
Ç'pati që s'ndenjti dhe ca  
T'i flisja kisha sevda

## *Çamarroekja*

S'të thoshin çapkëne  
Të flisnin çamarroke  
Luaje me djemtë  
S'luaje me shoqe

Kukullat s'i doje  
Luaje me top  
Gjuaje sa lodheshe  
Penallti në portë

Natën ëndërroje  
Që të bëhej ditë  
Po se si të ndodhi  
Dhe tu rritën gjitë

Doje ti ndaloje  
Dorën përmbi ta  
Ata nga inati  
Rriteshin dhe ca

Dhe një ditë s'dole  
Në fushën e sportit  
Plakat pëshpëritnin  
Gjeti udhën e zotit

## *Shqipëri çikë e strallit*

Shqipëri çikë e strallit  
I derdhe këngët e mallit  
Për djemtë lastarë mali  
Që s'i lodhi istikami

U dhe jetë, gjakun të dhanë  
Dritë për vatan e bënë  
Shkabë përmbi tramundanë  
Siç u kishe thënë, moj nënë

Jetë e tyre vleu vetëm  
Kur e dhanë për lirinë  
Ndaj s'kërkuan vdekje tjetër  
Veç t'u hapte nëna gjinë

Njëzetë e tetë mijë trima  
Zgjedhur një nga një me dorë  
Gjoksin rrahur suferina  
Ortek nga malet me borë

Plumbi vallë ku i mori  
Në ballë e te kraharori  
Gjaku që nga trupi rrodhi  
Puthi tokën e flakëroi

Flakëroi tek flamuri  
Gjaku që nga kohë e parë  
U bë zjarr e barut plumbi  
Nderohemi që jemi Shqiptarë

## *Lule e bukur, degë e njomë*

Më thanë shoqet, më thanë  
Ç'ka djali që të rri pranë  
Balluke e zeza mënjanë  
Gjeti sevdaja, sevdanë

E gjeti bilbili këngën  
E gjeti vashëza zemrën  
Faqe kuqja rremba-rremba  
Malli që më djeg përbrenda

Shih lulet si kanë çelur  
Fluturat si janë mbledhur  
Ç'vello të bukur kanë hedhur  
Trëndelinë mbi supe derdhur

Unë e dija që më doje  
Moj vetulla zeza pendë  
Rrotull shtëpisë ç'kërkoje  
Kur kish e kur s'kish hënë

Milonjë, e mira milonjë  
Lule e bukur, degë e njomë  
Bilbili që ligjëron  
Këngë dashurie këndon



## *O kurbet, të zëntë nëma*

Zemra derte zë e thotë  
Pikon gjak e pikon lot  
Pikon loti e plas guri  
Mbetur përtej detit burri

Varur dyfeku për muri  
Tharë shtrunga, nxirë hauri  
Më la nuse e u plaka  
Shami zeza, korba, nata

Nga dhembja rënkon gjiri  
Po si trete si qiriri  
Pa baba u rit biri  
Prit e prit sa iu tha syri

Si duron në dhe të huaj  
Hajde mos më lë të vuaj  
Hajde në këto male  
Je a s'je i gjallë fare

Bashkë ti heqim këto halle  
Pa bukë e pa pikë dhallë  
O kurbet të zëntë nëma  
Na hape plagë të rënda

## *Del nga varri, yll i rrallë*

Qaj, këndoj se më do xhani  
Se kishe shokë të rrallë  
Me dy vargje, këngë malli  
Dua të të mbaj të gjallë

Dhe i ëmbël, dhe i sertë  
Dhe i bukur, dhe i drejt  
Pse nuk vjen prapë në jetë  
Nuk deshe të ikje vetë

Del nga varri yll i rrallë  
Lis i lartë me gjithë rrënjë  
Dhimbja zemrën na ka tharë  
Ti i ri mbete në këngë

Një fjalë, derë më derë  
Dhe një dert i pashteruar  
Lumthi nëna, për ç'kish bërë  
Mjerë toka ç'mban në duar

Mos e mbaj, moj tokë e ftohtë  
Hiq dheun që ke mbi vete  
Të vijë të flasë me shokë  
Trim ishe, trim mbete

## *Thuaj pse s'më thua*

S'është e bukur kënga  
Thuaj pse s'më thua  
Qenka dashuria  
Ëndrrat e tua

Qenka dashuria  
Kockë e zemrës time  
Unë rritur me nënë  
Ti rritur jetime

Vesa me të rënë  
Dita më të marrë  
Hëna dashuruar  
Dielli pa dalë

Thuaj pse s'më thua  
Që ta thyej penën  
Unë gjirin tënd dua  
Ti më do me zemër

E bukur e pikë lotit  
S'të vete mëndja për mua  
Unë i mjeri i pa zoti  
Një fjalë të ëmbël dua

## *Ditën që t'ja marrësh këngës*

Ditën që t'ja marrësh këngës  
Të më thuash dhe mua  
Po s'i bëj rrahjet e zemrës  
Iso për këngët e tua

Se ka jeta dhimbje, derte  
Po dy jetë njeriu s'ka  
Njërën ta mbajë për vete  
Një për kohë të mëdha

Kush e sheh vetullën tënde  
Të bukur si jeta vetë  
Ose s'duhet të ketë mëndje  
Ose vetë s'duhet të jetë

Dhe në heshtsha, dhe në vdeksha  
Në u thafsha, në u tretsha  
Nga varri në mos u ngrehsha  
Po nuk bëj për tya vjersha

Po s'fole kur të vijë unë  
Ç'dreq inati ke, s'më thua?  
Unë s'rri dot, gjë pa të thënë  
Ti si rri e s'flet me mua

## *Ne pa ty, ti me rakinë*

Kur bëj poshtë Shurit Kuçë  
Të gjithë zogjtë më thonë  
Ik, aman e hiq tutje  
Nuk të lëmë në Buronjë

Ti, që çoç të duket vetja  
Se shkruan ca gërmërishte  
Nga ta dish, ç'është jeta  
Se ti je ai që ishe

Ti je ai që ke qenë  
Që do nderin, burrërinë  
Nuk të duam asnjë këngë  
Ne pa ty, ti me rakinë

Ne do ta gjejmë një vjegë  
Dhe e gjetëm kur u desh  
Kopeja që ka shelegë  
Dihet që nuk mban desh

Dua që të jem siç jam  
Kënga s'duron poshtërsinë  
Të gjitha vargjet që kam  
Ja jep veç njeriut t'mirë

## *Sa nisa të bëhem plak*

Pse si merr buzët e mia  
Brenda buzës tënde flakë?  
Ti sa çelur dashuria  
Unë sa nisur bëhem plak

Ti sa nisur hënë bërë  
Unë sa nisur jetën ngrysur  
Ti fustanin një pëllëmbë  
Unë tirqet gajtan stolisur

Unë një jetë para ty  
Ti një jetë prapa meje  
Nuk e di lule qershie  
Ç'kërkon që tallesh me mua

Unë e di që gjiri yt  
Mezi pret të çel beharë  
Po ç'faj kam, pse nuk më thua  
Që jam plak e nuk jam djalë

Unë vetë do ti them prillit  
Majit bukur i kam thënë  
Lulet që do çelin gjirit  
Vargje do mbeten për këngë

## *Balada e brengës*

Më rëndon një gurë i rëndë  
Më rëndon si gurë mulliri  
Mu bë shpirti mëngë-mëngë  
Copë e çik, zemra dhe gjiri

Mos merrni pe e gjilpërë  
Që të qepni gjirin tim  
Gjaku të rrjedh i tërë  
Të mëkëmbë Shqipërinë

S'jam i pari, as i fundit  
Që dheu do më mbuloi  
Në më doni, pse s'përkundni  
Djepin e kombit të rrojë

Po ç'i bë më dashuritë  
Thomëni ç'i bë më vallë  
Pse të vinin këto ditë  
Pse të vriten Shqiptarët

Të rreckosur ngrysem jetën  
Të gjakosur, po ashtu  
E kërkua të vërtetën  
E kërkujmë s'di se ku?!

## *Lumthi ne për këtë nënë*

Shqipëri madem i rrallë  
Lisi me rrënjë të thellë  
Këngën ndezur në strall  
Bijtë mbirë në bedenë  
Shqipëri

Djepet tundin trima  
Trimat rrënjë vende  
Kush i ka mëkuar  
Gjiri yt moj nënë  
Lumthi ne

Lumthi ne për këtë nënë  
E vogël e një pëllëmbë  
E vogël po zonjë e rëndë  
Gjirin flori e ergjëndë

Hallet e dertet e tua  
Të përzhitën nëpër shekuj  
Syri yt i përvëlur  
Syri përmbi kohëra tretur

Kush leu në prehrin tënd  
Di edhe se si të vdes  
Dhe matanë, Atlantikut  
Dhe përtej urës së Qabesë.



## *Mos e prish lodrën e tyre*

Bilbleshë pse s'përgjigje  
S'të vjen mall për ato vite?  
Kur ishe sa një mexhite  
Veshkë në dhjamë u rrite

Moj gushë lule zambaku  
Mot më mot m'u qep meraku  
Thashë më treti pak së paku  
Thashë më rrëgjoi, më plaku

Unë thosha, ç'thoshie ti?  
Paskam shumë inatçi  
O marrë atë djalë në gji  
O s'bëj kurrë nusëri

O nuse për atë djalë  
O do bëhem si e shkalë  
Do pres balluken mbi ballë  
Të mos ma kenë sevdanë

Ballukja do rritet prapë  
E argjend, dritë hënë  
Si mëndafsh e gjithë merak  
Luan me vetullën tënë

Aman, të keqen të syve  
Mos e prish lodrën e tyre  
Ti e vetmja trëndafil  
Mbirë në bahçen time

## *Bëj balluken palë-palë*

Sumbull e kumbull e kuqe  
Sumbull-o, kumbull-o  
Njëra nga gërshetat

Tok me ty fshin lëmë  
Tjetra gjithë naze  
Loz e qesh me hënë

Fol, mor fol se mu këpute  
Shtruar-o, fjalën-o  
Moj cula dyjare

Që bie mbi male  
Natën e beharit  
Me sevda të djalit

Atë balluken mbi ballë  
Thuaj si e do, o djalë  
Aman bëje palë-palë

Bëje vet, e shuaj mall  
Plassha po e lash pa marrë

*Tetor, 1987*

## *Moj e bukura si hëna*

Moj e bukura si hëna  
Përmbi sup tu ul thëllëza  
Ç'të thoshte ajo grykëzëna  
Mblidhi, moj lulet të tëra

Një nga një e bëji tufë  
Dhe vuri gjerdan mbi gushë  
Gjerdanë për gushë bëji

Ti marrësh thëllëzës zërin  
Të të mbushin lulet prehrin  
Të përqafohesh me drerin

## *Hajde se mbete atje*

Moj shamizeza katran  
Syri qan e zemra qan  
Qaj me lot a korbe e hasmë

Djali në Jemen të vate  
Shtatë vjet a nëntë janë  
Me zogj na dërgon selam

Djalin, nusen si i kam  
Djalë e nuse zemërdjegur  
Plasur buza, syri tretur

Ditë e natë për ty pyetur  
Ata treten, tretemi ne  
Hajde se mbete atje

Të na thashë lotët rrëke  
Në na gjetsh dot mbi dhe  
Në mos na gjetsh të gjallë

Të vish tek i shkreti varr  
Do ngrihemi vet një çik  
Vetëm të të puthim sytë

## *Zyqari, krua më krua*

Te kroi përtej në brinjë  
Të prita, sytë m'u thanë  
Ç'pate më këpute xhan  
S'erdhe vet apo s'të lanë

Në s'të lanë që të vije  
Përkarshi kroit të rrije  
Të tundje një bisht shamie  
A t'i thoshe një fëmije

Në s'deshe të vije vetë  
Ç'të kamë bërë, bejka shterpë  
Miq e shokë bëra lanet  
Tu qepa vjeshtë më vjeshtë

Të kërkojë e s'di seç them  
U bëra treqind dërhëm  
Dy a treqind dërhëm bërë  
Fajin e ke vetë të tërë

## *Ti je naze madhe*

Ti je naze madhe  
Si ngjala ne det  
Lum kush do të marrë nuse  
Lum kush do të ketë

Luaje me lule  
Si vala mbi breg  
Mblidhje manushaqe  
I mbaje në shep

Të japin aromën  
Apo t'i ua jep  
Të isha si to  
Që ta thithja vetë

Do vijë behari  
Siç erdhi dhe vjet  
Do vësh vello ballit  
A do merosh djemtë

## *Zgjatu merre mollën vetë*

Hidh e prit, moj monoftujë  
Hidh e prit një kokërr mollë  
Pse s'e hedh ta pres unë  
Duart e njoma t'u lodhë

Tu lodhën e t'u këpun  
Syzezë, leshra dërrudhë  
Moj gushëbardhë

Vjeshta, mollë mbushur plot  
Është stinë e nusërisë  
Po s'janë për ty me shokë  
Janë për djemtë astritë

Zgjatu merre mollën vetë  
zgjatu si zogu me fletë  
more djalë

Ato mollë të pa vrara  
Duket që për mua janë  
I prita të piqen mirë  
Tetëmbëdhjetë vjet me radhë



Aman ç'qenka dashuria  
Qenka zjarr që mban rinia  
Moj gushëbardhë

Kjo sevdaja paska punë  
Të lënka netëve pa gjumë  
Flladi i lehtë në behar  
Burimi që s'ka të tharë

Gurrë që s'shteron në jetë  
Të jep krahë të bën me fletë  
More djalë

Vjeshtë e parë vajti, shkoi  
E dyta po vjen ngadalë  
Hiq fustanin e vajzërisë  
Fustan nusesh të kamë marrë

Sa të vijë ajo ditë  
Si mbyll sytë me qerpikë  
Moj gushëbardhë

## *Lalëri, o këngërrënjë*

Mali mbi male të lartë  
Hijerëndë këndrevicë  
Të dy me çipinin bashkë  
I bëni djemtë me çikë

I rritët djemtë dhipllarë  
Një jetë mbinë mbi kalë  
Vetëtimë qiellin çarë  
Hundë më hundë me pashallarë

Lumi Vlorës, mor i sertë  
Ti që di e rrit Gjolekë  
Që më mbajte Bilbilenjtë  
Çdo shtëpi e bëre çetë

Kurvelesh, majë më majë  
Mblidhen djemtë nga kohët, tutje  
Jataganë e pallë larë  
Çepe rëndë me cullufe

Ngrehu, o Çelo Picar  
E fol me Çobo Golemë  
Burrat e rëndë si mban varri  
Se i do vendi në këmbë

Shokë shpjermëni në Kaninë  
Të shoh Ismail Qemalin  
Gjithë trimat do më vijnë  
Të vemi, ti puthim varri

Më duket se vjen nga deti  
Me Evropën inatosur  
Ylli, që një herë shkrep  
Mjekër bardhë, merak pa sosur

Labëri, moj këngërrënjë  
Gjiri yt u bë buronjë  
E vogël e një pëllëmbë  
Përmbi shekuj rri si zonjë

## *Të vete a të rri*

Ma bëri mikja me sy  
Ah i mjerë  
Si t'ia bëj as unë s'e di  
Ah i mjeri  
Të vete apo të rri  
Ah i mjeri  
A ti vete në shtëpi  
Ah i mjeri  
A të zë të bëj gaxhi  
Ah i mjeri  
Apo si merhum të rri  
Ah i mjeri

## *Paskam rënë në merak*

Mu këput zemra, i ziu  
Mu këput e s' derdhi gjak  
Me lot syri vetiu  
Paskam rënë në merak

Paskam rënë, po ç'kam bërë  
Se mbyll syrin nëpër natë  
Dhe xhinde të kishte qenë  
S'do më ndizte kështu flakë

S'do më bënte kaq të mjerë  
S'do më thante, s'do më tretë  
Unë që lozja me të tjerë  
Ç'kam tani që flasë me vete

Si të bëj e ç'ti them vallë  
Do lutem me përgjërime  
Ja të më lerë ja të më marrë  
Ja të bëhet nusja ime

Po dhe nuse në mos dashtë  
Të dalë që pa aguar  
Ta dijë do gdhihem jashtë  
Doemos e pres i zgjuar

Lagur nga vesa sa rënë  
Shtrirë mbi barin e njomë  
Me vështrimin si hënë e bërë  
Që më heq gjithë, ç'më mendojnë

## *Mbill një qiparis te varri*

Qamë me ligje moj vjehërr  
Se nuk kamë njerëz të tjerë  
Kullomë manaren e zezë  
Se lash një djalë sa lerë

Se më mori vdekja shkretë  
Akoma pa nisur jetë  
Edhe varri s' do më tretë  
Rritëm djalin siç di vetë

Vjehërr u rrita bonjake  
Pa nën' e dashuri vatre  
Ti më deshe dhe më pate  
Merr një qiparis e hajde

Mbill një qiparis tek varri  
Të vijë ta vadit djali  
Erën e nënës të marrë  
Ta shohësh që do më ngjallë

## *Kurbeti*

Nata sterrë, ulet reja  
Puth dallgën mbi det  
Vetëtin e shkrep rrufeja  
Një zemër pëlçet

Malli dogji, përvëloi  
Dhe goja nuk flet  
Nënë zeza si duroi  
Ajo nënë e shkret

Nusja që nuk nusëroi  
Kokën vë mbi djep  
Motra buzën drithëroi  
Pajën në sepet

Shushurimën preu kroi  
Rrapi s'tundi flet  
Kurbeti ç'plagë na shtoi  
Dhe ç'trima na treti



## *Fustan verdha cërka-cërka*

Fustan verdha cërka-cërka  
E dredh gushën si nepërka

Fustan verdha dritë hënë  
Pse nuk rri në punë tënde  
Fustan verdha si lëndinë

Ç' dorë të cingërisi gjinë  
Fustani lule tërfili  
Te unë të mbeti syri

## *Unë doja një vashë*

Kamë parë një ëndërr  
Sikur përvëlohem  
Digjem e zhuritem  
Dhe dot nuk shërohem

Zhuritem i mjeri  
Në prush e në shpuzë  
Lotët faqes rrjedhin  
Dhe mbeten në buzë

Shkon një bukuroshe  
Shkon një zanë mali  
Më hedh një pikë ujë  
Sa më ftohu ballin

Zë i flasë me zemër  
Me buzë të dridhur  
Loti kësaj bote  
Ç'qënka kaq i hidhur

Ç'qënka kaq i hidhur  
Qënka det i tërë  
Unë doja një vashë  
Zoti s'desh ta lërë

Unë doja një vashë  
Që të shkoja jetë  
Zoti s'ma dha mua  
Po e mori vetë

Zoti s'ma dha mua  
E mori në qiell  
Ndaj me kokën lartë  
Kërkoj një copë diell

Vete e vë lule  
Mbi një varr të shkretë  
Mbi gurrë të varrit  
Pikon lot i nxehtë

## *Më iku i vogël shumë*

Dal e pres djalin në udhë  
Mot më mot e nuk bëj gjumë  
Më pikon loti mbi gurë

Si ujët që rrjedh në gurrë  
Më iku i vogël shumë  
Val më valë, shkumë më shkumë

Aman toka përtej detit  
Ktheja shpejt nënës të vetmin  
Xhanin, e gjirin më treti  
Loti pa tharë më mbeti

## *O bilbil Shako Rexhini*

Shkoje si sorkadh mbi male  
Supet ngarkuar me halle  
Ç'le në shpellë të Tërbaçotëve  
Emrin tënd, shqotë pas shqote

Lumi Vlorës, derdhte gjëmë  
Tërbaçotët thurën këngë  
Dole në qafë të Gusmares  
I rrethuar me koshadhe

Këndrevica u tund sertë  
Ku vete bilbil me djemtë?  
- Do vete të varem vetë  
Të mos mbetet vendi shkretë

## *Dhe thanë - do vijmë prapë*

Nëna, pse u dhembka gjiri?  
Motra, përse derdhni lot?  
Palca janë, palë floriri  
Kohët nuk i tretin dot

U ikën djemtë dhipllarë  
Rrjedh e kohës i rrëmbeu  
Aq shumë sa, s'kishin parë  
Që nga koha e Skënderbeut

Kaluan dete me dallgë  
Të gjenin Evropën plakë  
Zemrën - shpuzë bënë varkë  
Dhe thanë - do vijmë prapë

Dhe kur mbetën përtej detesh  
U nisët t'u gjeni varrë  
Thinjat tuaja kontinentesh  
Klithmë që shkrep dhe strall

Kush piu gjirin e nënës  
Dhe nënën s'mbajti në gji  
Mos e paftë dritë e hënës  
Mos ju haptë ai sy

## *O ju zogjtë që fluturoni*

O ju zogj, që fluturoni  
Cicërimat që më keni  
Mi jepni ti hedh në vargje  
Dhe kënga ime të jeni

Po nuk ndezi shpirti im  
Të thoni që s'ka jetuar  
Qe një shpirt në përvëlim  
Qe i marrë, i harruar

Se nga varri do të ngrihem  
Këngën time do përflak  
Me të varg më varg do zihem  
Në s'i dhëntë kombit gjak

## *Ç'u bë besa që më dhe*

Më shkoi mikja në sokak  
Mu bë gjiri plagë  
Mu bush zemra me merak  
Dhe s'them dot një fjalë

Buzëbrëmjes dalë e rri  
S'e shuaj dot mallin  
Po ç'i bëra nuk e di  
Ku e pati hallin

Mos kërkonte pasuri  
Më rrëmbushet syri  
Kush ka bërë dashuri  
Di si ndizet gjiri

Nata vendin e ka zënë  
Mendimet s'më lënë  
Po kush rri në prehrin tënd  
Dhe lajkat ç'u bënë



Ç'u bë besa që më dhe  
Qe dhënë, herë të tjera  
Fjalët me gjithë mend s'i the  
Po të zuri besa

Kush plas zemër e pëlçet  
Se qenka me radhë  
Zemër e plasur s'ndizet shpejt  
Si herën e parë

## *Nuk i shuhet Shqipërisë pragu*

Pikon gjak e kullon vrer  
Një dhembje derë më derë  
Ikën djemtë, nuk u kthenë

Përtej deteve benë  
Shqipëri, o dhembje shumë  
Pikon lot e thërrmon gurë  
Aq sa s'kishe qarë kurrë

Pikon zemra, pikë gjaku  
Nuk i shuhet shqipes pragu  
S'suhet pragu i Shqipërisë  
Lumthi ne, kë pimë sisë

## *Herën e parë*

Mali uli majën  
Fusha rriti lule  
Unë doja burimin, djalë  
Ti flladin më prure

Shkelje lehtë-lehtë  
Mbi barin e njomë  
Bari ngrihej vetë  
Gjurmët mos të njomë

Thoshte jam i marrë  
Thoshte jam në ëndërr  
Vet dukësja xhinde  
Vet dukësja dhëndër

Më shpure në gurë  
Në njëqind burime  
Më the mos pi ujë  
Pi në buzën time

Unë xixëllonjë  
Shkrepa nëpër natë  
Sa më shkelje syrin  
Unë zhdukësja prapë

Aromë që lëshonin  
Lulet seç e bënë  
Kot që e kërkoja  
Ish në gjirin tënd

Yjet s'ishin tretur  
Hëna paskej punë  
Vetëm ëndrra mbetur  
Qenkësja në gjumë

## *Flamuri na ngrohu gjinë*

Që kur lindi historia  
Dhe gdhendi gërmën e parë  
Shkroi se në këto troje  
Ka pasur vetëm shqiptarë

Dallgë e hasmit, rrahu brigjet  
Por nga toka dot s'na shkuli  
Qëndruam siç rrinë burrat  
Gjirin na ngrohu flamuri

Plagë kur na hapi shpata  
Ne me sharkë gjakun e fshimë  
Plagë më plagë, male të larta  
Në gji tretëm vetëtimë

I shtruam sherqet mbi tela  
Dorën ngrimë përmbi pallë  
Se e dinim që liria  
S'vjen po s'e more plumbin në ballë

Nënat që na dhanë gjinë  
Me barut bashkë na i dhanë  
Dhe se njomën fare synë  
Për të rënë, kur na ranë

## *Ti valë që më nget Vlorën*

Ti moj valë, që më nget Vlorën  
Pse nuk më merr brenda gjirit  
Të jap këngët që kamë bërë  
Të japë dhe dritën e syrit

Dhe në heshtsha, dhe në vdeksha  
Në u thafsha, në u tretsha  
Brenda gjirit valës mbetsha  
Pse s'më jep shkumën moj valë

Plassha po se vura gushës  
Ti luan me lule bardhë  
Dhe unë flasë me vete udhës  
Valë e ëmbël të kamë thënë

Pranë ç'do peme ka një hije  
Ai nishani në gushë  
Njëmijë fjalë dashurie  
Mermë, mermë kaq e bukur

Asnjëherë ti s'ke qenë  
"Cigari më dogji buzën"  
Qerpikët sytë s'mi zënë.

## *Atë ditë pa dalë ylli*

Atë ditë pa dalë ylli  
një ves' shi  
Iku djali vetëm filli  
në Greqi  
Ju këput nënës nga gjiri  
çilimi  
Dy pika loti tek syri  
që të dy  
Nënë moj, e zeza nënë  
mjerë t'i  
Borë e madhe, borë e rëndë  
në kufi  
E ngriu djalin në këmbë  
dhe rron ti  
Botë jarane, bot' e sertë  
përmbi dhe  
Ç'ke, moj ç'ke që na merr djemtë  
Dhe na lë ne  
Nuk e dimë në i shohim  
dhe atje

## *Dil në penxhere*

Të, të shohë qerpikun  
Të, të vijë atje  
Dil në penxhere  
Thëllëzë e Golikut

Si lastarë rritur  
Për nuse stolisur  
Ç'sy të shkruar ke  
Sikur gjithë lulet e Majit

Kanë çelur atje  
Bën sikur s'më njeh  
Ç'më dogje vapë korriku  
Dhe ujë s'më dhe

Të dua më the  
Zogjtë e pyllit zunë e cicërojnë  
Një këngë për ne



## *Gjurmë më gjurmë t'u qepa*

Bilbili që thua vjersha  
Thuamë dhe mua dy rreshta  
Thuam' dy rreshta dhe mua  
T'ia këndojë asaj që dua

Leshverdha deri në thua  
Leshverdha si trëndelinë  
Lëri moj, nazet e tua  
Lër' nazet si gjeraqinë

Kur më mbush ujë në krua  
Ç'ma rrotullon ashtu synë  
Me vështrimin tënd më thua  
Hajt të dalim në lëndinë

Gjurmë më gjurmë t'u qepa  
Siç kërkon nektarin bleta  
Atje tek më the, të gjeta  
Atje ku ndërtohet jeta

## *Vajtimi i nënës*

O mali me trëndelinë  
Si duron e bën durim  
Që lë fëmijën jetim  
Dhe nusen me rrokullimë

Pesë vjet aq të rënda  
Brodhe botën atë hëna  
Mbolle lot tek, shkeli këmba  
Gjumë nate s'bëri nëna

Nëna s'fjeti dhe ti s'fjete  
Malli si qiri të tretë  
Shaminë e lotit në xhep  
Nata njomte, dita errte

Atë ditë që m'u ktheve  
Mu kthye gazi në derë  
Ku ta dinte nëna plakë  
Që do nxirrte shaminë prapë

Nga erdhi gjitha ajo gjëmë  
Të shkelim plumbat me këmbë  
Vriten djemtë ditë për ditë  
Bëmë varrezat si shtëpitë

Bir o bir plumbi të mori  
Tej për tej te kraharori  
Asnjë fjalë buza s'të nxori  
Vajza një lule të hodhi

Vajza derdhi lotin valë  
Si do rritem e pa babë  
Duam jetë, s'duam të vrarë  
Duam Shqipërinë e gjallë

## *Nënë, do marrë një udhë*

Nënë, do marrë një udhë  
Do kaloj udhë pa udhë  
Do ta vë hënën në shtrungë  
Se hallet kështu na zunë

Një vëlla sa një çetë  
Mbeti përtej, detit shkretë  
Dheu i botës nuk e mban  
Do vete ta kërkoj vetë

Dhe deti po të më dalë  
Do hedh këmbën, valë mbi valë  
Do bëhem, si erë e marrë  
S'kthehem po s'i gjeta varrë

Në mos ardhshim të dy tok  
Merr një rrënjë borzilok  
Mbille, vadite me lot  
Dhimbjen tonë do të thotë

Nënë, do marrë një udhë  
Zemërplasur, plagë shumë  
Lot i nxehtë mblidhet në buzë  
Pikon pikë, thërrmon gurë

## *Argjiro, djep floriri*

Argjiro, djep floriri  
Ç'të thotë zemra për Çerçisë  
Çepenë mbi supe  
Ta rreh erë e malit gjerë

Dora mbi kobure  
Emri mbetur nëpër këngë  
Hallall, moj i qoftë gjiri  
I doli zotë Shqipërisë

Shkreptin mbi dhjetëshe syri  
Thyhen dallgët e stuhisë  
Nëna njëh krismën e birit  
Mbi taborët e Turqisë

Në Mashkullorë te rrapi  
Shkruhet faqe e historisë  
Ti në këmbë mbi bllok mermeri  
Rri në roje të lirisë

## *Merr koburen vramë moj*

Kur veje për ujë moj  
Po si veturë  
Merr koburen vramë moj  
Se nuk dua jetë.

Balluket e ballit moj  
Laj e krihi përpjetë  
Merr koburen, vramë moj  
Se nuk dua jetë.

Ç'kanë djemtë e fshatit moj  
Që s'të lënë të qetë  
Merr koburen vramë moj  
Se nuk dua jetë.

Si ylli ndër yje moj  
Jeshë moj e shkretë  
Merr koburen, vramë moj  
Se nuk dua jetë.

Jeshë naze madhe moj  
Si ngjala në det  
Merr koburen vramë moj  
Se nuk dua jetë

Për ty vogëlushe moj  
Dheu s'do të më tretë  
Merr koburen vramë moj  
Se nuk dua jetë

## *Ju të ngordhur të pëgërë*

*“Atyre që në maj 1995, prishën  
bustin e Memo Metos”*

Bastardë, pjellë bastarde  
Memua ishte, mal mbi male  
Të gjallë, dot nuk e vratë  
Të vrarë e vratë prapë

Pika t’u bjerë në kokë  
Ishte trim që s’kishte shokë  
Ishte burrë që s’njihte lot  
Ishte fjalë që s’shkonte kotë

Ishte trëndelinë maji  
Ishte melodi longari  
Ishte prush e shpuzë zjarri  
Ishte plumb për tradhtarin

Ishte këngë, ishte dert  
Ishte det, ishte tërmet  
Ishte zemër, që buçet  
Ishte shqiponjë me fletë

Ç’bëni kështu, mor të mjerë  
o të shtyrë e të pështyrë  
Trimat vriten veç njëherë  
Dhe derë më derë mbijnë



Si duroni, moj kuçjote  
Eshtrat e djemve, te varri  
Dridhen e rënkojnë fort  
Nuk vritet, Memo oratori

Nuk rivritet oratori  
S'thyhet vetëtima shtizë  
Lumtë Kuçi, ç'djalë nxori  
Lumtë Labëria, e gjithë

Na hapën në zemër plagë  
Plagë e vjetër, dregëz zënë  
Po do ngrihet, Memua prapë  
Dhe në vrimë do ti gjejë

Ju të ngordhurit pëgërë  
Që nuk latë, asgjë pa bërë  
Shitët motër, babë e nënë  
Nëma e kombit do tu zërë

Heronjtë, s'bëjnë shaka  
Pjellin kohë të mëdha  
Populli në gji i mban  
Duan apo, s'duan ca

Memo, bir i Labërisë  
O i rrituri me derte  
Lum nëna që të dha sisë  
Monument mbi kohëra mbete

## *Ç' mu bën këngët*

Ç' mu bën këngët, ç' mu bënë  
Ato këngë lozonjare  
Që i këndonim pa gdhirë  
Bilbilat ndënë dritare

Ngridheshin vashat na gjumi  
Hapnin cepin e perdhesë  
Frynte lehtë erë e lumit  
Zgjonte lulet e bahçes

Këngët ç' mu bënë  
Këngët e rinisë  
Shkruar tek qershia  
Në buzë të avllisë

Lulet e qershisë  
Zbardhur nëpër fletë  
Nuk i merrte dora  
I merr buza vetë

Zjarri dashurisë  
Nuk paska të shuar  
Cili e kujtoi  
Dhe e ka harruar

Cili i kërkoi  
Dhe s'i erdhën pranë  
Vitet prushëruar  
Dashuri e parë

## *1 ngjita buzët shushunjë*

I ngjita buzët shushunjë  
Në gushën tënde të bardhë  
Sytë mbylla si për gjumë  
Dhe u bëra si i marrë

Ato lule ç'kanë bërë  
Mbledhur aromën të tërë  
Në atë gush' e paskan vënë  
Për të tjerat s'kanë lënë

Moj me qumësht e ke larë  
A ka rënë bor' e parë  
Dritën e hënës ke marrë  
Apo lule kaçet ranë

Atë gushë gjithë rrathë  
U firova kur e pashë  
U vilanosa e rashë  
Qënka jeta ime thashë

Ajo gushë me gjerdanë  
Bor' e pa shkelur në male  
E bukur e hanë - dane  
Nazet si nepërkë e larme

## *Më trëmbe ballin e kopesë*

Moj mu bërë për martesë  
Lule trëndelinë  
Më erdhe pranë nomesë  
Trëmbe ballin e kopesë

Ballin e dhëne më trëmbe  
I bërë me besë tënde  
I shpure vende më vende  
Dhe tek sharku im u gjende

## *Po qan vëllai, vëllanë*

Po qan vëllai, vëllanë  
Ku i gjen i mjeri  
Ku i gjen ligjet vallë  
Ku mi more ato plagë

Aman bashkë ti kishim ndarë  
Sos të prenë, sos të vranë  
Që hakun të kisha marrë  
Po buzë më buzë ranë

Pse s'tu bënë gurët fletë  
Të më bije lehtë-lehtë  
Ç'ti them kunatës së shkretë  
Moj kunatë, moj Dukjote

Shtatë palë rrëkeje lotëve  
Buzë e çarë jeta jote.

## *Djepi që nuk shteron kurrë*

Vlorë, gjëmim madhja Vlorë  
Deti dallgë, malet borë  
Bijtë tek shkrepin kurorë  
Ndezin kohërat, bëjnë fora  
Djepi trimave....

Labëria ime  
Djepi që nuk shteron kurrë  
Do e mos e dije  
Që rrit burra për flamurë

Gjyshërit tanë çepë rëndë  
U ngritën me gjithë varre  
I mblodhe sonte të tërë  
Në sofrën tënde bujare

Mblodhe djemtë, palcë floriri  
Rrahje zemre, dhimbje gjiri  
Majë shpate, dritë syri  
Që çanë mure mjerimi

Udhëve Evropës plakë  
Zogj të vetëm, nëpër natë  
Ballë dirsur, zemër plagë  
Tek ky truall do vijne prapë.

*Shkurt, 1995*

## *Bejka*

Një natë bejka  
Doli vetëm në bahçe  
Zgjata dorën që ta zërë  
Më tha djalë mos më nga

Mos më se, nuk jam rritur  
Jam një gonxhe, që po çel  
Sa të vij behari pritëm  
Pastaj hajde mermë erë

Ç'më thua kështu, moj vitë  
Zemrat çelën kurdoherë  
Për to s'ka dimër e vjeshtë  
Për to ka vetëm pranverë

Mos u vilanisë e mjera  
Se unë për shaka ta thash  
Për ç'do natë hapur penxherja  
Të pret që të rrimë bashkë

Do lë stanin e kopenë  
Dhe kërrabën po aty  
Sharkun culen gjithë ç'qenë  
Dhe në gjirin tënd do vij



## *Këngët e mallit*

Në Këngët e mallit  
Cula dyjare shtruar  
Sharkun supeve çobanit  
Shpuzën e zjarrit pa shuar

Këngët e mallit na dëgjojnë  
Dhe malli e djeg njerinë  
Edhe zogjtë që fluturojnë  
S'rrojnë dot pa suferinë

Shqipëria halle shumë  
Shqipëria derte madhe  
S'mbyllte sy, e s'bënte gjumë  
Pyeste shqiponjën mbi male

Shteteve nga vajte, shkove  
Udhëve Evropës mbarë  
Ndonjë natë a na kujtove  
Që t'ia merrnim labçe bashkë

Këngët i kishe, me vete  
Këngët e vendlindjes tënde  
Kalojnë mbi shtatë dete  
Dhe bien dhembshuri nëne

## *Sorkadh i bukur*

Dhe fshihej e zhdukej  
Ashtu e kish hallë  
Një sorkadh i bukur  
Monopatin marrë

Marrë monopatin  
Një sorkadh i bukur  
Ç'e hedh ashtu hapin  
Si yll i këputur

Si yll i këputur  
Atje lart në qiell  
Ja puthet me hënën  
Ja tretet në diell.

## *Pata frikë mos e trëmbe*

Atje tek lugu me pënjë  
Buzën në cule kesh vënë  
Mu mblodhën, zogjtë të tërë

Cicërimat kishin lënë  
Çoç do thoshin, po s'e bënë  
Pse s'e thonë, kush kish thënë

Larë flori e ergjëndë  
Pjekur si pjeshkë bërë  
Këndoj e syrin s'e ngrenë  
Pata frik se mos e trëmbe

## *Do më përvëlojë malli*

Këndokam një këngë të rëndë  
S'është këngë, është gjëmë  
Më pikon loti i rëndë  
Më therka gjiri si nënë

Më bie dhembje kurbeti  
Të mjerën nënë, ç'e gjeti  
Djalin si det e tërmeti  
E përcolla atje mbeti

Më mbeti në dhe të huaj  
Kush e bëri gjëmën time  
Po ju thafshin këmb' e duar  
Mos i paftë zëmra gëzim

Se mezi e kisha rritur  
Dhe më përvëloi gjirin  
Gjithë jetën e zhuritur  
Dhe dot nëna s'ia pa syrin

Aman ti moj dhogë e varrit  
Do vesh të mi thuash djalit  
Do më përvëlojë malli  
Gjer sa atje të marri

## *Xhan bajame*

Nga malet s'ka ikur bora  
Xhan bajame  
Dale-dale  
Dale, moj bajame dale  
Ndënë degën tënde shkova  
Një lule me buzë mora  
Dhe me një zog, ta dërgova

Prita lajm e si durova  
Ditën që haberin mora  
Puth e puth, mallin s'ta nxora.

## *As sorkadhe, as thëllëzë*

Atë ditë në stane ç' deshe  
Mu duk hëna pikë vese  
Hodhe një vështrim e qeshe  
Thëllëzë a sorkadhe jeshe

As sorkadhe, as thëllëzë  
Po jam një vashë sa bërë  
Në merak me ty kam rënë  
Zë e llafosem me hënë

Sevdaja më ndjek dhe mua  
Ato gërshetat e tua  
Shtatë palë, s'ke ç'u thua  
Shtatë pëllëmbë mbi supe lëshuar

Kur i thur ato gërsheta  
I vadit me dashurinë  
Rriten e bëhen si dega  
Të tjera gërsheta mbinë

Mëndja atje më ka mbetur  
Ndaj jam tharë, ndaj jam tretur  
Ilaç tjetër nuk kam gjetur  
Balluken tënde mbi vetull

Hesht mor hesht se ka jatrua  
Që shëron plagët e tua  
Jatroi që shëroi mua  
Zemra që të thotë të dua

## *Gërshet verdha*

Gërshet verdha më hëngre  
Që valëvite mbi gjirin  
Lëri gjinjtë shih punën tënde  
Luaj me qerpik të syrit

Thuaj hënës të mos dalë  
Se hënën e ke mbi flokë  
Sos zgjat dorën, o djalë  
Dhe hënën se more dot

Gjaku zemrës mu firua  
Kur i pash buzët e tua  
Sos janë buzët për mua  
Puthi t'i e tjetër s'dua

Ai nishani në faqe  
I vogël si pikë loti  
Fol me të se nuk bën naze  
Doemos që është joti



Shtegut vetullës të shkova  
Më mbetën sytë mbi ballin  
Unë kastile këtej dola  
Që ti shohësh ti, o djalë

Kur i fryn asaj balluke  
Duket sikur fryn veriu  
Në je djalë mos bën tutje  
Se pritet era vetiu

## *Doli vashëza një mbrëma*

Doli vashëza një mbrëma  
Ajo doli, s'doli hëna  
kaçullatë si thëllëza  
Thotë e ëma futu brënda

Futu brënda, moj e shkretë  
Se do të vështrojnë djemtë  
Të qepen e dot s'i ndjek

Thonë fjalë çoç kërkojnë  
Sytë vetullat me bojë  
Faqet të kuqe si mollë  
Buzët që të përvëlojnë

Këta djemtë e fshatit tënë  
Të vesh për ujë s'të lënë  
Shtegun e udhës të zënë  
Mbyllin syrin, bëjnë gjëmë

Doli vashëza, një mbrëma  
Ajo doli, s'doli hëna  
Thonë djemtë mos u fut brenda  
S'thonë ata, u thotë zemra

## *Kurvelesh o djep' i nderit*

Historia shpalos fletët  
I shpalos palët flamuri  
Kurvelesh o djep' i nderit  
Kurvelesh me besë burri

Vijnë e u dëgjojnë zënë  
Bilbilenjtë këngë më këngë  
Vijnë komisarët radhë  
Asimi me Mustafanë

Malet e lartë hijerëndë  
Male ngarkuar me borë  
Male mbuluar me këngë  
Male që mbajtën dëshmorë

Përmbi male ti je ngritur  
Më merr malli të vij pranë  
Të rri ulur nëpër brigje  
Ti takoj trimat me radhë

Shkuan vitet, lanë gjurmë  
Ti s'fjete një natë i qetë  
Si gurrë që s'shteron kurrë  
Suferinë i derdhe djemtë

Mbi çdo gur', e mbi çdo shkëmbë  
Në çdo cep të tokës mëmë  
Gërmon e veç plumba gjen  
Tregojnë luftën që ke bërë

## *Fryn një erë*

Fryn një erë, tund një malë  
Këput lulet prushëruar  
Lehtë-lehtë e hollë-hollë  
Tek fle vasha e mbuluan

Ca lule ndenjën mbi flokë  
Ca mbi faqe, ca mbi gushë  
Njëra si një borzilok  
Vajti i ndënji në buzë

Syrit tim nuk i shpëtoi  
U qasa dalë nga dalë  
Vasha çapin e dëgjo  
Hapi qerpikët si halë

Hapi buzën buzëqeshi  
Lulja nuk lëvizi fare  
I mjeri zemra ç'më deshi  
Të dy gropëzat në faqe

Lulen që mbeti në buzë  
E mora me dorën time  
Ato që qenë mbi flokë  
Mbetën vello nusërie

## *Djalë, o djalë*

Atë ditë që të përcolla  
Djalë, o djalë  
Përtej detit të dërgova  
Nuk e di se, si durova

Perëndisë ju përgjérova  
o Zot bjermani si molla  
Gjithë djemtë që ka Vlora  
Gjithë djemtë e vendit tonë

Se mezi i pret ç' do nënë  
Na merakuj gjumë s' flënë  
Mos u hyftë gjëmbë në këmbë

## *Shkon një vashë o shokë*

Shkon një vashë beronjë  
Shkon një vashë o shokë  
Duke tundur supet- o  
Shkon si sorkadhja në borë

Sikur qe rritur në Vlorë  
Vetullat ngritur kurorë  
Sikur ballit çoç i thonë  
Shtatin si lastarë i njomë

Mesin lum kush t'ia vështrojë

## *Shkon një djalë hipur në kalë*

Deti s'paska fare valë  
Një pëllumb i bardhë  
Seç më thotë ca fjalë  
Mjegull mbi Sazan ka ranë

Ëndërr e kesh parë  
Seç më thotë, më thotë ca fjalë  
Dielli s'dashka të dalë  
Shkon një djalë hipur në kalë

Nuk e di ku e kesh parë  
Hidh syrin, ndizte strallë  
Më kujton kohën e parë  
Kur isha vajzë pa dalë



## *Zë e silloisem*

U ula i mjeri  
Në rrëzë të kalasë  
Zë e silloisem  
Po me kë të flasë

Po pse silloisesh  
Pse thua i mjerë  
Shtati në të rritur  
Kënga në të çelë

Moj vajzë ç'e dua  
Këngën plasë buzë  
Kur s'hedh sytë mbi mua  
Po merr udhën tutje

Ku të mbeti qejfi  
Djalë pse s'më thua  
Buza ime mbeti  
Në buzët e tua

Cili qe si unë  
Dhe s'njohu rininë  
Mos i paftë kurrë  
Lulet kur të mbijnë

## *Pilotëve*

Emrat të dyve s'ua di  
Ju kini vetëm një emër  
Emri juaj - Burrëri  
Se ju e shpëtuat nënën

Buzëmbremja bie ngrirë  
Përmbi Tepelenën, flakë  
Qiellin dyfekët ngrinë  
Gjurmët e tyre i patë

S'qenë plumba për të vrarë  
Qenë plumba për t'u thënë  
Përse merrni ato armë  
S'kemi lerë nga një nënë?

Nëpër kufijtë në mes zhurmës  
Zëri i nënës vjen në vesh  
Mosni thotë gjaku i zemrës  
Nuk vritet një Kurvelesh

Dhe ju ikët, ikët, ikët  
U dhëmbi avioni i juaj  
Ishte djersa e pikë e pikës  
Pse të vini në dhe të huaj

Loti i syrit na pikoi  
Kur u pamë që ishit larg  
Shqipëria u uroi  
Rrofshi bijë që s'bëtë gjakë

Dhe mbi gjithë ligjet që lindën  
Ka një ligj që s'thuhet kurrë  
Kush në gji të kombit hyri  
S'del nga gjiri mbetet burrë

*“Kushtuar dy pilotëve që në vitin 1997, refuzuan të  
zbatojnë urdhrin dhe u larguan në Itali”.*

## *Çeli moj trëndelinë*

Çeli moj trëndelinë  
E sheh, a s'e sheh, moj e mirë  
Thëllëzat shpatit iu ngjinë

Ujë në barëra pinë  
Ia thonë këngës që dinë  
Aman të jap djalërinë

Gjithë ç'kam të marrësh tinë  
Po më lë të kullos synë  
Tek gjiret që sapo mbinë

## *Me gjithë Shqipërinë flas*

Rri në tavolinë i menduar  
Gjuhën e huaj nuk e di  
Kërkoj një birrë pak i truar  
Vetmisë, ti bëj shoqëri

Qënkam memec këtë buzëbrëmje  
Qënkam i pagojë vërtet  
Të flisja me dikë ma kisha ënda  
Dhe fola me penën që shket lehtë

Përballë meje poetët shqiptarë  
Vendet kanë zënë në tribunat e kohëve  
Andej i flasin Kristos përmetar  
Bjere këtu, mos e lër qosheve

Ai del nga “koha jonë”  
Me hapin nazeli djaloshtar  
Shqipen përkëdhel në gojë  
Ashtu si di një përmetar

S’qënkam memec këtë buzëbrëmje  
Me gjithë Shqipërinë flasë  
E di, Kristo në vitrinën tënde  
Gjithë poetët e kombit do ti ngas

*Kristo – librashitës në librarinë e librit shqip  
“Koha jonë”.*

## *Flamurin të kuq e kemi*

Flamurin të kuq e kemi  
Se me gjak e kemi ngjyer  
Me gjak e me majë shpate  
Shkruam faqe historie

Shkabën e zezë me dy krerë  
Vumë në mes të flamurit  
S'e lamë të dridhet njëherë  
Se i dhamë besën e burrit

Ç'besë lirisë i kemi dhënë  
Gjithë brezat që kemi qënë  
Ramë e s'lamë asnjë pëllëmbë  
Ballas hasmit dhëmbë më dhëmbë

## *Zë nga larg të njoha*

Po një pikë vese  
Të ra mbi qerpikë  
Nëpër natë ç' deshe  
S' u trembe një çikë?

S' u trembe që dole  
S' kishte hënë e yje  
Mua më kërkoje  
A ku dreqin vije?

Na dy xixëllonjat  
Që ndrinin mbi gjinjtë  
Që nga larg të njoha  
Që vije, moj vitë

Që nga larg të njoha  
Dhe dola të prita  
Syrin tënd çapkën  
Me sy e sodita

Ti i ule sytë  
Ashtu siç di ti  
Nata s'kishte hënë  
Hëna qe në gji

Unë e pash i mjeri  
Dhe s'dija ç'të bëja  
Tek dy xixëllonjat  
Më kish mbetur mendja



## *Pse nuk ngrive, mal i lartë*

Shkojnë ditë, shkojnë vite  
na merr malli  
Të vijmë të, të puthin sytë  
biro xhani  
U këpute, yll i bukur  
nëpër natë  
Nënë zeza pret e pret  
t'i vish prapë  
Qan me lot e qan me ligje  
qajnë gurë  
Si qyqe brigje më brigje  
s'pushon kurrë  
Të priste të vije bashkë  
me gjithë nuse  
Ti i vajte, mal i lartë  
një burbuqe  
Pa ngrehu, ngrehu një herë  
si floriri  
Se të pret hapur kjo derë  
të pret gjiri

## *Bijtë e tu moj Tepelenë*

Do marrë gjak nga gjaku tyre  
Shufrën e dyfekat penë  
Të gdhënd mbi kurorë dafine  
Djemtë e tu moj Tepelenë

Tepelenë çikë e strallit  
Treqind e ca yje ballit  
Nëna u puth synë  
U mban plagët ngrohtë

Ulet u puth gjinë  
Bij o bij ju thotë  
Istikameve u ngrenë  
Këndrevicë me vetëtim

Si i doje ashtu benë  
Këngë e këngëve për trima  
U këpun ca yje ranë  
U këpun e nuk u shuan

I mban flamuri në palë  
Shqiponja në kraharor

## *Një labe si vita*

Një këngë thëllëze nga gjumi  
ç'më zgjoi  
Pashë një bandillë dhe moj  
që lahej te kroi  
Një labe si vita hedhur  
si lastarë  
Faqet shegë e ndezur moj  
vetullën biskonjë  
Flokun trëndelinë  
si mëndafsh në dorë  
Ç'ma plagose zemrën moj  
kush do ma shëroj  
Kush do ma shërojë  
të shkretën

## *Dil o sy i zi*

Moj mu bëre, për martesë  
Dil moj dil, lulja me vesë

Dil moj dil, buzën trëndafil  
Dil moj dil, të takosh bandill

Manxuranë e penxheresë  
Dil moj dil, lulja me vesë

Vetëm hidhmë, sytë e zezë  
Të ti puth, e le të vdesë

Pa dil ti, sy i zi  
po kush del, aman si ti

## *Këngëtarit Vezir Balili*

Ç'më dhembka zemra, më dhëmb  
Bie për gjumë, s'më zë  
Kam një dert e kam një brengë  
Edhe këngët do ti lë

Do ta lë këngën e shkretë  
S'kam ç'e dua pa bilbilë  
Pa bilbilin, s'ka pranverë  
Edhe pylli, s'është pyll

Ti Vezir, që ligjëroje  
Dhe do më ligjërosh prapë  
Këngë trimash më këndoje  
Ti i thellë, ti i lartë

Ti Vezir, që Vezir mbete  
Dënuar njëqind e një  
Unë do t'u thosha grekëve  
Lërmëni të rri me të

Lërmëni, që ti puth synë  
Të ç'mallem vet me bilbilë  
Bilbilenjtë, do të më vijnë  
Janë pa tretur në Janinë

Labëria ç'të kish thënë  
Ç'të kish thënë e mira nënë  
Prei hekurat me dhëmbë  
Dhe hajde në gjirin tënë

Vezir Balili me derte  
Mes për mes nëpër dyfeqe  
S'të mbajnë burgjet greke  
Mbylle sy, po gjumë s'fjete

Kur u ç'faqe atë natë  
Ngriu zemra, nënës plakë  
Baba me lotin në faqe  
Dridhej e s'të thoshte dot hajde

Ajo nuse plagë marrë  
U këputë e s'tha një fjalë  
Vëllai dhe motrat radhë  
Vetëm vajza tha: o babë

## *Djalë i bukur*

Bie për gjumë, s'e zë  
Qerpiku s'më mbyllet

Vjen një djalë i bukurë  
Desha te lozja me të

Ngrihem hap dritarenë  
Si sorkadhja natën

Frynë ere mëngjesit  
Vetëm me ëndrrën më lë

## *Zasu vashë të them dy fjalë*

Lotët e tua ngjyrë ari  
Varen faqes tatëpjetë  
Të lënë njolla në faqe  
Në zemrën time të shkretë

Qasu vashë të them dy fjalë  
Të, të lë një amanet  
Kur të vdes të, të kemë pranë  
Të më zësh me dorë vetë

Kurorë me degë dafine  
Të më çosh te, varri i shkretë  
Të qash mua të zinë  
Se nuk kthehem më në jetë

Në mal të ma bëni varrin  
Ku ka barë e trëndelinë  
Të më rrishë, Vitore pranë  
Ndezur të ma mbash qirinë



## *Puth ballin tënd Shqipëri*

Kamë puthur përjetësisht ballin  
tënd Shqipëri  
Dhe malet e tu brënda gjirit tim  
i mbaj  
Flakën e vetëtimave, të tu mbaj  
në sy  
Dhe gjithë globi më thotë  
Shqiptarë  
Se jam gatuar nga palca e kësaj  
toke  
Dhe nder e besë me qumështin tënd  
më ke dhënë  
Dhe të më japin arin e tërë kësaj  
bote  
Kurrë nuk e ndërroj me fjalën  
nënë  
Pëllëmbë për pëllëmbë i kam shkelur  
këto troje  
E historinë e tyre  
kamë pirë  
Ndërsa qënia ime ëndërronte  
të më thoshte bir  
Jam ulur në bedena  
të kalave  
Vringëllima shpatash e jataganësh  
kam dëgjuar

Klithma ujqish kam tretur pas  
mesnate  
E mëngjeset më kanë gjetur  
sy zgjuar  
Fletë më fletë historinë e kamë  
hapur  
Kam folur me kohërat, kam folur  
me heronjtë  
Fletë më fletë, zambak i kuq  
gjaku  
Flete më fletë kombi  
mbijeton  
Nënat rritin djepe, djepet tretin  
tramundanë  
Hallet male përmbi supe, supet maja  
që s'u thanë  
Rrënja-gjaku, gjaku-bajrak, syri-pishë  
fjala-shpatë  
Shekujve barutin thatë, binit  
e ngriheshit prapë

Kjo balta jote na ngopi të tërëve  
Ndaj dhe emrin tënd kemi marrë  
Bir pas biri e shqotë pas shqote  
Gjëmoi zëri ynë, jemi Shqiptarë

Putha përjetësisht, ballin tënd Shqipëri  
Dhe kokën në prehrin tënd kamë vënë  
Këngët e tua mbaj në gjë  
Me zërin e një kombi të them, Nënë

# Përmbajtja

Në vend të parathënies .....	7
Kosova ka djalërinë .....	11
Vura buzën përmbi culë .....	12
Fëminia .....	14
Gruas .....	16
E vogëla .....	17
Ç'më ngacmove .....	18
Shqipëri të ndriti nuri.....	21
Në ëndërr më vije .....	22
Kush pi ujë në krua.....	24
Dil Hanko .....	25
Ç'u bënë ata djem .....	26
Udhët e Evropës .....	27
Ç'ka mikja që s'flet .....	28
Labëri moj lezet madhe .....	29
Apo pret beharin tjetër .....	30
Po mikja në mos tregoftë .....	31
Ah! Moj Tepelenë .....	32

Legjenda e një engjëlli .....	33
Fryn thellim .....	35
Një ves mbi mal ra .....	36
Çamarrokja .....	37
Shqipëri çikë e strallit .....	38
Lule e bukur, degë e njomë .....	40
O kurbet, të zëntë nëma .....	41
Del nga varri, yll i rrallë .....	42
Thuaj pse s'më thua .....	43
Ditën që t'ja marrësh këngës .....	44
Ne pa ty, ti me rakinë .....	45
Sa nisa të bëhem plak .....	46
Balada e brengës .....	47
Lumthi ne për këtë nënë .....	48
Mos e prish lodrën e tyre .....	49
Bëj balluken palë-palë .....	51
Moj e bukura si hëna .....	52
Hajde se mbete atje .....	53
Qyqari, krua më krua .....	54
Ti je naze madhe .....	55
Zgjatu merre mollën vetë .....	56
Labëri, o këngërrënjë .....	58
Të vete a të rri .....	60
Paskam rënë në merak .....	61
Mbill një qiparis te varri .....	63
Kurbeti .....	64
Fustan verdha cërka-cërka .....	65
Unë doja një vashë .....	66

Më iku i vogël shumë .....	68
O bilbil Shako Rexhini .....	69
Dhe thanë - do vijmë prapë .....	70
O ju zogjtë që fluturoni .....	71
Ç'u bë besa që më dhe .....	72
Nuk i shuhet Shqipërisë pragu .....	74
Herën e parë .....	75
Flamuri na ngrohu gjinë .....	77
Ti valë që më nget Vlorën .....	78
Atë ditë pa dalë ylli .....	79
Dil në penxhere .....	80
Gjurmë më gjurmë t'u qepa .....	81
Vajtimi i nënës .....	82
O mali me trëndelinë .....	82
Nënë, do marrë një udhë .....	84
Argjiro, djep floriri .....	85
Merr koburen vramë moj .....	86
Ju të ngordhur të pëgërë .....	88
Ç'mu bën këngët .....	90
I ngjita buzët shushunjë .....	92
Më trëmbe ballin e kopesë .....	93
Po qan vëllai, vëllanë .....	94
Djepi që nuk shteron kurrë .....	95
Bejka .....	96
Këngët e mallit .....	97
Sorkadhi i bukur .....	98
Pata frikë mos e trëmbe .....	99
Do më përvëlojë malli .....	100

Xhan bajame .....	101
As sorkadhe, as thëllëzë .....	102
Gërshet verdha .....	104
Doli vashëza një mbrëma .....	106
Kurvelesh o djep' i nderit .....	107
Fryn një erë .....	109
Djalë, o djalë .....	110
Shkon një vashë o shokë .....	111
Shkon një djalë hipur në kalë .....	112
Zë e silloisem .....	113
Pilotëve .....	114
Çeli moj trëndelinë .....	116
Me gjithë Shqipërinë flas .....	117
Flamurin të kuq e kemi .....	118
Që nga larg të njoha .....	119
Pse nuk ngrive, mal i lartë .....	121



ZAHO BALILI  
PUTH BALLIN TËND SHQIPËRI

---

Formati: 12 x 20 cm  
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA  
Tel: ++355 4 22 40 116  
Tiranë, 2011